



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 08.03.2022)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:13 dhe mbaroi në orën 10:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.

2. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor”, vend vakant i cili është krijuar për shkak të dekretimit ditën e djeshme nga ana e Presidentit të Republikës, të zotit {...}, si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Gjithsesi, për më shumë sqarime lidhur me listën emërore, unë do ftoja zonjën Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, për të na shpjeguar me detaje për kriteret e listës.

Maela Alicanaj: Faleminderit, Kryetare!

Këshilli me vendimin nr. 293, ka miratuar zgjedhjen e tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, të cilët janë:

1. Znj. {...}.
2. Z. {...}.
3. Z. {...}.
4. Znj. {...}.
5. Znj. {...}.
6. Znj. {...}.
7. Znj. {...}.
8. Znj. {...}.

Lista është miratuar së fundi në janar të vitit 2022 pas vakancës së krijuar nga zoti {...}.

Tashmë, për shkak të Dekretit nr. 13497, datë 07.03.2022 të Presidentit të Republikës, i cili ka emëruar si gjyqtar të Gjykatës së Lartë, zotin {...}, është e nevojshme që vakanca e krijuar në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor të plotësohet.

Sipas përcaktimve të nenit 146 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është Këshilli i Lartë Gjyqësor që ka detyrimin ligjor për përzgjedhjen me short të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Në nenin 146, i cili flet për përbërjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, pika 6 e këtij neni parashikohet se: “6. Në rast se krijohen vakanca në përbërjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, vakanca plotësohet sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj vetëm nga gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, sipas ligjit nr. 84/2016, deri në datën e krijimit të vakancës.”.

Duke qenë se vakanca është krijuar në datën 07.03.2022, atëherë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, është krijuar lista me gjyqtarët të cilët kanë kaluar me vendim të formës së prerë procesin e rivlerësimit deri në datën 07.03.2022. Gjithashtu, në konformitet me parashikimet e nenit 148, duhet që në këtë listë të mos përfshihen gjyqtarë për të cilët është vendosur fillimi i çështjes penale, kanë në fuqi një masë disiplinore, është filluar procedim disiplinor si dhe gjyqtarët që janë në detyrë në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Nga informacioni i dërguar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, në listën e paraqitur nuk ka gjyqtarë ndaj të cilëve: a) është vendosur fillimi i çështjes penale; b) është në fuqi një masë disiplinore; c) është filluar procedim disiplinor.

Gjyqtarët të cilët plotësojnë kriteret ligjore:

Gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit sipas ligjit 84/2016; Nuk janë përfshirë gjyqtarët e Gjykatës kundër Krimit të Organizuar; gjyqtarët të cilët janë në skemë delegimi po në këtë gjykatë; gjithashtu nuk do të përfshihen në këtë listë gjyqtarët të cilët ndonëse kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, janë të komanduar me vendim të Këshillit dhe nuk janë aktualisht duke ushtruar funksionin e gjyqtarit dhe kemi konkretisht 6 gjyqtarë që plotësojnë këtë kriter: z. {...}; znj. {...},

znj.{...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}; nuk do të përfshihen në këtë listë 5 (pesë) anëtarët e Këshillit nga radhët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit; znj. Marçela Shehu, znj.Irena Plaku, z. Dritan Hallunaj, znj.Brikena Ukperaj dhe z.Ridvan Hado; gjithashtu edhe 2 (dy) gjyqtarët ish–anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.{...} dhe znj.{...} të cilëve u ka mbaruar mandati më datë 12.12.2021, në konformitet me përcaktimet e nenit 4 të Ligjit nr.115/2016, pika 3 i cili parashikon se: “... Anëtari i Këshillit nuk mund të transferohet, të ngrihet në detyrë ose të delegohet gjatë 3 viteve pas përfundimit të mandatit.”, e parë kjo në raport me parashikimet e nenit 146/3 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor, brenda 24 orësh nga hedhja e shortit, miraton me vendim zgjedhjen e gjyqtarëve si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Anëtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor delegohen në këtë detyrë me mandat 4-vjeçar.”

Në dispozitën e mësipërme (neni 146) në pikën 2, përcaktohet se shorti për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor hidhet jo më vonë se 48 orë nga data e përcaktimit të datës së zgjedhjeve me të afërta, sipas këtij ligji. Në të përcaktohet gjithashtu se shorti hidhet në praninë e publikut, përfaqësuesve të KQZ-së, partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë.

Duke qenë se edhe për vakancën do të zbatohen të njëjtat dispozita si edhe zgjedhjen e anëtarëve, rezulton se pas organizimit të shortit, sipas dispozitës së sipërcituar pika 3 e saj, Këshilli brenda 24 orësh nga hedhja e shortit duhet të miratojë me vendim zgjedhjen e gjyqtarit si anëtar në plotësimin e vakancës dhe do të ketë mandat deri në përfundimin të mandatit të anëtarëve aktualë të Kolegjit, të zgjedhur me vendimin nr. 293, datë 09.09.2020. Gjithashtu gjyqtari bën edhe betimin.

Duke marrë parasysh kriteret e sipërcituara, lista me magjistratët që plotësojnë të gjitha këto kriteret përbëhet nga 45 magjistratë, sipas listës që ju e keni (juridiksioni i apelit dhe juridiksioni i shkallës së parë).

Nëse keni pyetje.

Naureda Llagami: Nëse nuk kemi diskutime, vijojmë me procesin e votimit?

Klodian Kurushi: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord, me kundërshtimet që kam parashtruar për përfshirjen e znj. {...} dhe z. {...} në këtë listë që në vendimin e mëparshëm.

Ridvan Hado: Më falni, po e njëjta gjë vlen edhe për mua.

Marçela Shehu: Dakord, me të njëjtën rezervë si zoti Hado dhe zonja Luli pasi edhe unë nuk kam qenë dakord që në këtë listë të mos përfshihen dy ish-anëtarët e Këshillit, zoti {...} dhe zonja {...}, pasi ashtu siç kam theksuar, nuk shikoj asnjë ndalim ligjor dhe asnjë shkak ligjor për mospërfshirjen e këtyre dy ish-anëtarëve në procedurat e shortit për përzgjedhjen e anëtarit të ri të Kolegjit Zgjedhor. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Dakord me listën.

Klodian Kurushi: Dakord me listën.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Të miratojë listën e gjyqtarëve të cilët përfshihen në shortin për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë:

1. {...}
2. {...}
3. {...}
4. {...}
5. {...}
6. {...}
7. {...}
8. {...}
9. {...}
10. {...}
11. {...}
12. {...}
13. {...}
14. {...}

15. {...}
16. {...}
17. {...}
18. {...}
19. {...}
20. {...}
21. {...}
22. {...}
23. {...}
24. {...}
25. {...}
26. {...}
27. {...}
28. {...}
29. {...}
30. {...}
31. {...}
32. {...}
33. {...}
34. {...}
35. {...}
36. {...}
37. {...}
38. {...}
39. {...}
40. {...}
41. {...}
42. {...}
43. {...}
44. {...}
45. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Më lejoni t'ju informoj që në orën 12:00 do të hidhet shorti në ambientet e KLGJ-së. Në këtë proces janë të ftuar mediat dhe të gjithë personat e interesuar. Ftoj të gjithë anëtarët të jenë prezent. Pas hedhjes së shortit do të bëhet mbledhja plenare për miratimin e gjyqtarit që do të rezultojë nga shorti, në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor. Faleminderit!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

**PROCESVERVBAL MBI HEDHJEN E SHORTIT PËR PLOTËSIMIN E VENDIT
VAKANT NË KOLEGJIN ZGJEDHOR GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 08.03.2022)

Hedhja e shortit u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:15.

Merrnin pjesë në hedhjen e shortit:

- 1. Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Përfaqësues nga stafi i administratës së KLGJ-së.*
- 3. Përfaqësues i KQZ-së.*
- 4. Përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të medias.*

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin e tij nr. 85, 08.03.2022, vendosi të miratojë listën e gjyqtarëve të cilët përfshihen në shortin për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, si më poshtë: {...} – {...} (lista me 45 magistratë).

Bazuar në nenin 146 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor të përzgjedhë me short vakancën e krijuar në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, jo më vonë se 48 orë nga përcaktimi i datës së zgjedhjeve më të afërta.

Duke qenë se z. {...} përmes Dekretit nr. {...}, datë 07.3.2022 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë, trupa gjyqësore e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor ka mbetur me 7 (shtatë) gjyqtarë, duke u krijuar një vakancë.

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13438, datë 20.01.2022, ka dekretuar gjithashtu datën për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetarë bashkie në 6 njësi të qeverisjes vendore, ndaj Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor të plotësojë vakancën e krijuar në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor.

Procedura e shortit si vijon:

Nga stafi administrativ i Këshillit, hidhen një nga një 45 shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve në enën e qelqit (lista e sipërcituar), duke u treguar përpara kamerave dhe të pranishmëve. Ena e qelqit trazohet, për t'u përzgjedhur më pas një nga goglat që ndodhen në enën e qelqit.

Kandidati i përzgjedhur për plotësimin e vendit vakant në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor rezulton: 1.{...}.

* * *

(Hedhja e shortit deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor